



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 49 ,50 dhe 51 të Ligjit për ndërtim nr 2004/15 dt. 27.05.2004, nenit 2 të Udhëzimit administrativ inspektimi teknik i objekteve ndërtimore nr. 65 Nr. i prot. 26/05, neni 15, al. 1, shkronja "b" të Statutit të Komunës së Prishtinës nr.01-110-391 dt. 25.02.2010 dhe nenit 17 paragrafi 1 pika "b","d" dhe "e" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 dt. 20.02.2008, duke vendosur sipas kërkesës së bashkëpronarëve **Hamide Miftari, Adem Luta dhe Hatixhe Uka** nga Prishtina, dhe investitorit "**Pozhegu Brothers**" Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, me nr. 05-351-7258 dt. 04.05.2011, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i Komunës së Prishtinës, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET bashkëpronarëve Hamide Miftari, Adem Luta dhe Hatixhe Uka nga Prishtina, dhe investitorit "**Pozhegu Brothers**" **Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë**, përdorimi i objektit shumëbanesor B+P+5+NK, të ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 740/21, të evidentuar në fletën poseduese nr. 607, Komuna Kadastrale Matiqan, në bllokun urbanistik C15, të tërësisë C, Të Planit Rregullues "Mati 1", i ndërtuar sipas Lejes së Ndërtimit me nr. 05-351-13171 dt. 27.05.2009, si dhe Konkluzionin për plotësimin dhe ndryshimin e Aktvendimit 05-351-13171 dt.27.05.2009, të lëshuar Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

II. Objekti do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje nga pika I dhe dokumentacionin teknik .

III. Objekti nga pika I. e këtij Aktvendimi mund të përdoret dhe shfrytëzohet nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.

IV. Ky Aktvendim do të shërbejë si bazë për regjistrimin e objektit të përshkruar në pikën I të këtij Aktvendimi në evidencat përkatëse Kadastrale.

A r s y e t i m

Bashkëpronarët Hamide Miftari, Adem Luta dhe Hatixhe Uka nga Prishtina, dhe investitorit "**Pozhegu Brothers**" Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, me kërkesën 05 nr. 351-7258 dt. 04.05.2011, i është drejtuar Drejtorisë për

Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës Prishtinës, me të cilën ka kërkuar lëshimin e lejes së përdorimit të objektit, në ngastrën kadastrale nr. 740/21, të evidentuar në fletën poseduese nr. 607, Komuna Kadastrale Matiqan, në bllokun urbanistik C15, të tërësisë C, Të Planit Rregullues "Mati 1", me që rast ka dorëzuar këtë dokumentacion:

- o Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit investues të dt. 20.03.2011.
- o Dokumentacioni përcjellës teknik të lidhura si libër(kopja e Lejes së ndërtimit, Lejes urbanistike, Konkluzioni lidhur me ndryshimet e projektit kryesor me at zbatues me nr. 05-351-13171/1 dt.25.03.2011, etj)
- o Certifikatat dhe atestet të lidhura si libër.

Drejtoria e Urbanizmit Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pas shqyrtimit të provave të lëndës e konkretisht, procesverbalin e komisionit për kontrollim teknik të dt. 20.03.2011, ku secili anëtar ka bërë kontrollimin teknik të objektit ndërtimor investues dhe kanë konstatuar se, objekti investues është ndërtuar në pajtim me aktvendimin e cekur më lartë dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti përmbushë normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të objekteve të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, t'i lëshoj lejen e përdorimi, andaj kjo Drejtori vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 49,50 dhe 51 të Ligjit për Ndërtimin nr 2004/15 i fuqizuar me Rregulloren 2004/37 dt 14.10.2004.

Udhëzimi juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes kësaj drejtorie në afat brenda prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.


I dorëzohet: Investitorit, kadastër dhe në lëndë, arkivit.

**DREJTORIA E URBANIZMIT, NDËRTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
TË KOMUNËS SË PRISHTINËS 05 nr 351-7258 dt. 28.12.2011**

E punoi:
F.Rrahmani jur.dip.



E kontrolloi:
Ferit Fazliu, idn



DREJTOR
U.D Behxhet Musliu jur.dipl

